



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 14 nëntor 2022  
Nr.ref.:RK 2074/22

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI119/22**

Parashtrues

**Naser Durr**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë**  
**së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml.nr.4/2022 të 14 korrikut 2022**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Naser Durr nga fshati Shillovë, Komuna e Gjilanit, i cili përfaqësohet nga Mustafë Musa avokat nga Gjilani (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml.nr.4/2022] të 14 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PAKR.nr.390/2021] të 15 dhjetorit 2021 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [PKR.nr.77/2020] të 1 shtatorit 2021 të Gjykatës Themelore në Gjiilan – Departamenti për të mitur (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar [Pml.nr.2/2022] të 14 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 22 korrik 2022.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes së cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura para Gjykatës Kushtetuese**

6. Më 4 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 8 gusht 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi, anëtarë.
8. Më 10 gusht 2022, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të sjellë autorizimin për përfaqësim pranë Gjykatës. Po ashtu një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 18 gusht 2022, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin e kërkuar.
10. Më 27 tetor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 26 qershor 2020, Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria Themelore) kishte ngritur aktakuzë [PP.I.nr.60/2020] kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale Sulm seksual nga neni 229 paragrafi 6 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK).

12. Më 1 shtator 2021, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR.nr.77/2020] e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të kryerjes së veprës penale, sulm seksual nga neni 229 paragrafi 6 i KPRK-së, dhe e dënoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës 30 maj 2021 deri më 24 qershor 2021, dhe masën e arrestit shtëpiak prej 24 qershorit 2021 deri më 23 korrik 2021. E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike u udhëzua në kontest civil.
13. Më 7 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të Kodit Penal, me propozimin që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe parashtruesi të lirohet nga akuza, apo i njëjti të anulohet dhe lënda atë kthehet në rigjykim dhe rivendosje në shkallë të parë. Ankesë kishte parashtruar edhe Prokuroria Themelore.
14. Më 15 dhjetor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.390/2021] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, si dhe ankesën e Prokurorisë Themelore, dhe Aktgjykimin [PKR.nr.77/2020] të 1 shtatorit 2021 të Gjykatës Themelore e vërtetoi.
15. Më 28 dhjetor 2021, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozimin që të aprovohet kërkesa si e bazuar dhe të ndryshohen aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore dhe të lirohet nga aktakuza, ose të anulohen aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe dytë dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
16. Më 14 korrik 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr.4/2022] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.

### **Pretendimet e parashtruesit**

17. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml.nr.4/2022] e 14 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë duke i shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
18. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës duke theksuar se Gjykatat e rregullta me theks të veçantë Gjykata Themelore kishte refuzuar pranimin e provave të paraqitura nga mbrojtja e tij, ku lidhur me këtë ai pohon se *"[...] Gjatë rrjedhimit të procedurës pran Gjykatës Themelore në Gjilan, me qellim të vërtetimit të drejtë dhe të plote të gjendjes faktike, mbrojtja ka propozuar gjykatës edhe shtjellimin e provave me daljen e gjykatës në vendin e ngjarjes dhe leximin e dy hartave ortofotiove, të nxjerra nga Gjeoportali i Republikës së Kosovës, në rrethanat që të vërtetohej pozita e shtëpisë së oborrit të akuzuarit dhe thëniet e të miturës, nënës së saj Kaltrinë Kajtazi dhe gjyshes së saj - dëshmitares Kimete Kajtazi, të cilat, po qe se do të administroheshin këto prova, do të ishin në kundërshtim të plotë me gjendjen faktike"*.
19. Tutje parashtruesi i kërkesës thekson se *"... në aktakuzë ceken me sa vijon: i akuzuari kërkon nga e mitura që zhveshët, por e mitur nuk pranon, ndërsa vet i hjek të tëra rrobat, pastaj e merr viktimën e ule në organin gjenital..."*, çka jep me nënkuptuar

meqë viktima ka refuzuar te zhvishet, i akuzuari e ka marruar dhe e ka vendosur ne organin e tij gjenital, qe jep me nënkuptua se ka përdorur një lloj force, e që patjetër ne trupin e njom te viktimës duhet te mbeteshin gjurmët e se paku mavijosje, porse nga deklarata e gjyeshes-deshmitares Kimete, vërtetohet se e njëjta atë mbrëmje e ka pastruar viktimën dhe se ne trupin e saj nuk ka vërejtur asnjë gjurmë, se kinse te njëjtës për qetësim i ka dhënë ilaçin e tipit Diazepan DMG, çka duke u nisur nga mosha e viktimës kjo sasi e këtij bari, do te ndikonte që e njëjta se paku te jetë ne gjumë 2 dite, ndërsa nga dëshmia e dëshmitares Kimete, vërtetohet se ditën e nesërme, viktima është zgjuar me kohe nga gjumi dhe se normalisht pas kryerjes se mëngjesit, ka përcjellë mësimet online. Nga dëshmia e te miturës, vërtetohet se e njëjta ne shtëpinë e te akuzuarit ka qëndruar 1 deri 2 minuta dhe se gjate gjithë kësaj kohe, dera e hyrjes se shtëpisë dhe dera e sallonit kur ka qëndruar se bashku, kanë qen te hapura plotësisht tere kohen, çka edhe logjika e shendosh nuk jep me nënkuptua se a ka mundur i akuzuari te ndërmer veprimet e lartcekura në këto rrethana, mendoj se përgjigjja nuk donë koment”.

20. Në fund parashtuesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që të anulohen aktgjykimet e gjykatave të rregullta dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

### **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

#### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

##### **Neni 31**

##### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.  
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”  
[...]

#### **Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës**

##### **Neni 229**

##### **Sulmi seksual**

1. Kushdo që prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin e tillë të prekë kryesin apo personin tjetër për qëllim seksual, pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet.  
[...]  
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj personit nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet, kryesi dënohet me burgim prej dhjetë (10) deri në njëzet (20) vjet.  
[...]

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

21. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113  
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

*[...]*

23. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”*

24. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ajo e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml.nr.4/2022] e 14 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

25. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nën rregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

*(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetet në mënyrë të njaftueshme pretendimin e tij.*

26. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastet e Gjykatës K104/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; dhe K175/20, parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
27. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284; shih gjithashtu rastin K104/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin K175/20, cituar më lart, paragrafi 38).
28. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të tekstit, përkritazi me vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin K104/21, cituar më lart, paragrafi 28).
29. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata përkujton që Gjykata Themelore e kishte shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale Sulm seksual nga neni 229 paragrafi 6 i KPRK-së, dhe e kishte dënuar me dënim me burgim prej 3 (tre) vitesh, duke ia llogaritur qëndrimin në paraburgim dhe arrest shtëpiak. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ankesa e të cilit ishte refuzuar nga Gjykata e Apelit dhe ishte vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, ku kjo e fundit e kishte refuzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.
30. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.



31. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës, duke arsyetuar [...] *“Gjatë rrjedhimit të procedurës pranë Gjykatës Themelore në Gjilan, me qellim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja ka propozuar gjykatës edhe shtjellimin e provave me daljen e gjykatës në vendin e ngjarjes dhe leximin e dy hartave ortofotiove, të nxjerra nga Gjeoportali i Republikës së Kosovës, në rrethanat që të vërtetohej pozita e shtëpisë së oborrit të akuzuarit dhe thëniet e të miturës, nënës së saj K.K dhe gjyshes së saj - dëshmitares K.K, të cilat sikur të shtjelloheshin këto prova, do të gjendeshin në kundërtënie të thella me gjendjen faktike”.*
32. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, të cilat si të tilla ngrenë çështje ligjshmërie dhe si rregull i përgjithshëm bien në juridiksionin e gjykatave të rregullta dhe jo të Gjykatës Kushtetuese.
33. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues *Limak Kosovo International Airport J.S.C.*, “Adem Jashari”, Aktvendim për Papranueshmëri i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues *Gani Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
34. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, aplikimi nr.30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura atje; dhe rastet e Gjykatës KI128/18, të cituara më lartë, paragrafi 56; dhe KI62/19, të cituar më lart, paragrafi 58).
35. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar se në bazë të cilave prova dhe në bazë të të cilave dispozita materiale kanë nxjerrë aktgjykimet përkatëse, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të të drejtës materiale.
36. Së pari, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [PKR.nr.77/2020], shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës lidhur me veprën penale sulm seksual nga neni 229 paragrafi 6 i KPRK-së, dhe e dënoi me dënim me burgim prej 3 vitesh, duke ia llogaritur edhe kohen e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, me arsyetimin se “[...] *Trupi gjykues pasi analizoi, i shqyrtoi dhe i administroi të gjitha provat personale dhe materiale ka gjetur se i akuzuari me datën 27.05.2020 në fshatin Shillove e ka prekur të dëmtuarën e mitur T.K e lindur me datën 19.10.2010 në atë mënyrë që pasi e ka parë se në rrugë e ka përshëndetur dhe duke qene se ai e ka pyetur për familjen e saj kjo ka menduar se është i ndonjë i afërm i të dëmtuarës e pastaj i akuzuari e ka pyetur se a dëshiron ëmbëlsira dhe ajo është përgjigjur se jo nuk dua, e pastaj ajo ka hyre brenda dhe të dy janë ulur në një divan (kauç) dhe i akuzuari e ka pyetur prap se a donë ëmbëlsira por ajo ka refuzuar e pastaj ka kërkuar që e mitura të dishet por*

ajo nuk ka pranuar, kurse ky i ka hekur rrobat e veta dhe e ka marr viktimën e ka ulur mbi organin gjenital ne prehrin e tij, pastaj ka filluar me e prekë në pjesët intime te miturën përderisa ajo është munduar ta kafshoj në duar dhe ka arritur që të lirohet nga duart e te akuzuarit e pastaj i ka marr atletet (patikat) e saj ne duar dhe ka vrapuar ne drejtim te shtëpisë se gjyshërve te saj. E kur ka arritur tek shtëpia e gjyshërve ajo ka shkuar drejt ne katin e dyte ne dhome. Pas një kohe aty ka shkuar gjyshja e cila e ka vërejtur te shqetësuar te dëmtuarën e ka pyetur se çka ka por ajo është përgjigjur se është mërzhitur për nenën e saj. Atë nate ajo ka qene mjaft e shqetësuar dhe për ta qetësuar gjyshja e saj i ka dhënë medikamente dhe atë një "diazepan 2 miligram". Të nesërmen pas dite te dëmtuarën e ka marr gjyshi dhe e ka dërguar tek nena e saj. Pasi që nëna e të dëmtuarës e ka vërejtur se e ajo është e shqetësuar ajo e ka pyetur se çfarë i ka ndodhur, por një kohe e dëmtuara e mitur ka hezituar qe te i tregojë pas insistimit te nënës se saj i ka treguar dhe pastaj ajo e ka dërguar te miturën ne Emergjencën e Spitalit te Përgjithshëm ne Gjilan, është sjellur me date 30.05.2020 T.K nen përcjellje te policisë me zyrtaren për shërbime policore për tentim dhunime. ".

37. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.390/2021] refuzoi si të pa bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ku ndër të tjera theksoi "[...] Kolegji i Gjykatës se Apelit, ka vlerësuar ankesën, e mbrojtësit se te akuzuarit Naser Durr, avokatit Musafë Musa, aktgjykimin e ankimuar si cihe shkresat e tjera te lendes, edhe ka ardhur ne përfundim se gjykata e shkalles së parë ne këtë çështje penale në mënyrë te cirejte cihe te plote e ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila gjendje 'faktike është vërtetuar si nga provat personale, sikurse janë deklarata e te dëmtuarës T.K e dhënë ne seancën dëgjimore për hetuesi te veçantë te mbajtur me dt. 15.06.2020, deklaratat e dëshmitarëve K.K, K.K, E.R dhe L.R, pastaj nga provat materiale, sikurse janë, raporti i foto albumit, raporti i këqyrjes se vendit të ngjarjes, procesverbali i deklaratës se te dëmtuarës te dhënë ne QPS ne Gjilan me dt. 30.05.2020, deklarata e te akuzuarit Naser Durr, te dhënë në Stacionin Policor ne Gjilan me dt. 30.05.2020, anamneza mjekësore e lëshuar nga Spitali Regjional i Gjilanit, Ekstrakti i lindjes për te miturën T.K, procesverbali i te intervistuarit Naser Durr i dt. 19.06.2020 si dhe informacionet e personit. Nga raporti i këqyrjes se vendit te ngjarjes te dt. 30.05.2020 dhe aty e shihet se zyrtaret policor kane qenë te shtëpia e te akuzuarit dhe aty kane takuar bashkëshorten e të akuzuarit dhe nga aty janë marrë dy palë pantolla pune ngjyrë hiri dhe një kapelë pune me ngjyrë krem. Nga anamneza e dt.30.05.2020 shihet se e mitura ka qenë në spitalin e përgjithshëm ne Gjilan nën përcjellje te policisë dhe [ zyrtares se QPS është udhëzuar që të konsultohet me gjinekologjen dhe psikiatrin, pasi qe është kontrolluar e mitura është udhëzuar qe ne shtëpi të përdorë një lloj bari. Nga ekstrakti i lindjes shihet se e dëmtuara e mitur T.K është e lindur me 19.10.2010, dhe ne ditën kur ndaj saj është kryer vepra penale e njëjta i ka pasur 9 vite e 7 muaj. Kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se gjykata e shkalles se pare drejte ka vepruar kur i ka falë besimin deklaratës së të dëmtuarës e cila që nga fillimi i procedurës hetimore e deri në përfundimin të shqyrtimeve gjyqësore i ka dhënë deklaratat e njëjta duke mos e ndryshuar rrjedhën, përshkrimin dhe përmbajtjen e ngjarjes. Po ashtu drejtë ka vepruar edhe kur i ka falur besimin deklaratës së dëshmitares K.K, e cila e ka përshkruar momentin prej kur e dëmtuara ka shkuar ne shtëpinë e saj pasi ka ndodhur rasti, drejte ne katin e dytë te shtëpisë se gjyshërve, mjaft e shqetësuar, e ka pyetur por ajo nuk i ka treguar se çfarë kishte ndodhur me te, por i ka thënë ta thërret nenën e saj. Gjithashtu, me te drejte i është falur besimi deklaratës se dëshmitares K.K, për arsye se deklarata e saj ishte ne përputhje te plote duke e përshkruar ne mënyrë identike gjendjen e te miturës pasi qe ka ndodhur ngjarja, e po ashtu këto deklarata të dëshmitarëve Kimete dhe Kaltrina, ishin në përputhje edhe me provat materiale te administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, e sidomos me anamnezën mjeko ligjore".



38. Në fund, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës vendosi edhe Gjykata Supreme, e cila e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në tërësi. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme përmes aktgjykimit Pml.nr.4/2022, ndër të tjera arsyetoi “[...] Edhe këto pretendime sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara dhe nuk e vënë në dyshim aplikimin e ligjit penal. Fillimisht vlen të theksohet se nga shkresat e lëndës dhe provat e administruara në këtë çështje veçanërisht deklaratat e të dëmtuarës se mitur (e cila në kohën e kryerje të veprës penale ka qenë nëntë vjeçare) në Qendrën për Punë Sociale dhe Prokurori në prezencë të përfaqësueses ligjore të saj, të dënuarit dhe ekspertit të psikiatrisë dhe pjesërisht edhe nga mbrojtja e të dënuarit nuk rezulton se kemi të bëjmë me një ngjarje që është jashtë realitetit ashtu siç pa baze pretendon mbrojtësi. Pastaj, i dënuari nuk është akuzuar dhe shpall fajtor për shkak se duke e përdorur dhunën e ka kryer veprën penale të sulmit seksual ndaj të dëmtuarës, po për shkak se ka prekur për qëllime seksuale, kurse, është evidente se për ekzistimin e kësaj veprë penale përveç elementeve objektive ‘duhet të përmbushet edhe elementi subjektiv - dashja, por sipas vlerësimit të kësaj gjykate në këtë çështje juridiko penale me asnjë prove nuk vihet në dyshim saktësia e fakteve vendimtare të vërtetuara me vendimet kundër të cilave është paraqitur kërkesa jo vetëm sa i përket përgjegjësisë penale të të dënuarit dhe elementit subjektiv (dashjes), por edhe elementeve tjera të veprës penale për të cilën është shpall fajtor dhe gjykuar, pra, kjo gjykate mbështet në tërësi konkludimin e gjykatave se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën ai është gjykuar. [...]”.
39. Gjykata thekson që në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i vërtetimit të gabuar të fakteve, thekson se, Gjykatat e rregullta kanë bërë vërtetim të gabuar të provave, megjithatë ai nuk e mbështet në asnjë mënyrë dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar qartazi të njëjtat (Shih rastet e Gjykatës KI64/20, parashtrues *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41; dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
40. Për më tepër, bazuar nga shkresat e lëndës, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi po ashtu që në fazat e ndryshme të procedurës t’i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t’i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtarë; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjyrimi i 21 janarit 1999, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42; dhe KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).
41. Thënë këtë Gjykata vlerëson se Gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, ku në bazë të provave të nxjerra ishte vërtetuar se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe me këtë rast,

të njëjtat ishin shpallur si të pa bazuara. Sa më sipër, Gjykata thekson se parashtuesi i kërkesës nuk ka arritur që pretendimet e tij për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë t'i ngrejë në nivel kushtetutshmërie.

42. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së janë (i) pretendime që bien në kategorinë e “shkallës së katërt” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtuesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 27 tetor 2022, njëzëri:

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Radomir Laban



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Gresa Caka-Nimani